



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

<b>Datë /a/e:</b>	24.01.2020
<b>Referencë:</b>	07-353/04-14140/20
<b>Për / Za/ To:</b>	Federata e Atletikes e Kosovës
	Drejtoria se Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	
<b>Kontrolloi:</b>	Udhëheqësi i Sektorit: Habib Ogrri
<b>Punoi:</b>	Punoi zyrtari :Sabri Gashi
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes QSHQ, ka pranuar kërkesën e Federatës së Atletikes së Kosovës , për shfrytëzimin e hapësirës publike për mbajtjen e aktivitetit-krosin e bardhe në Gërmi

Qëllimi i kërkesës është organizimi i krosit nga Klubi Atletik i Prishtinës ku marrin pjese 300 garues nga Kosova .

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

#### Pëlqimin

Federata e Atletikes ka kërkuar shfrytëzimin e hapësirës publike në Gërmi .

Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e krosit te bardhe me atlet te Kosovës ne distancën 700 m .

Organizimi i aktivitetit lejohet të mbahet me 02.02.2020 nga ora 11:00-14:10.

Për nevoja te aktivitetit vendoset një Tende me dim 3.00x3.00 m ne hapësira të betonuara, si dhe caku 3.00x1.00m

Organizatori obligohet që:

- Nëse nuk ka bore e ne mënyrë qe të ruhet hapësira gjelbëruese aktivitetin duhet ta mbani ne rrugën mbi restorante ose poshtë restoranteve ne marrëveshje me Policinë e Kosovës dhe komunitetin i cili duhet te jete e njoftuar për ketë aktivitet (pasi munde te pengohet qasja e tyre) dhe paraprakisht në marrëveshje me policinë të lajmërohet një dite me herët shtegu që do te shfrytëzohet për kros .

- të mos paraqesin pengesë për lëvizjen e lirë të qytetareve;

- organizatori duhet te përmbush kriteret e mbajtjes se Krosit dhe të sigurohen pjesëmarrësit.,

- pas përfundimit të afatit të dhënë nga Drejtoria Tenda me objektet ndihmese duhet të largohet dhe hapësira të kthehet në gjendje të mëparshme .

Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.